

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6242
E mërkurë, 17 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

Sot 13 vjet nga
shpallja e pavarësisë
së Kosovës IFAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



GJYKATA SPECIALE KA MBAJTUR KONFERENCËN E TRETË STATUSORE NDAJ
THAÇIT, VESELIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT IFAQE 4-5

MBROJTJA E ISH-DREJTUESVE TË UÇK-së: PROKURORIA PO NA VËSHTIRËSON HETIMET



Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, është ankuar se prokuroria po ua vështirëson hetimet. Avokatët kanë

kërkuar që prokuroria ta dorëzojë sa më shpejt dosjen paraprake të lëndës në mënyrë që ata të mund të përgatiten për hetimin. Mirëpo prokuroria ka bërë me dije se dëshmitarët janë arsyetja kryesore

që dorëzimi i dosjes paragjyqësore apo paraprake duhet të lidhet me datën e gjyqimit. Ndërsa mbrojtja ka vlerësuar se frikësimi i dëshmitarëve është slogan dhe se nuk ka të bëjë me realitetin

KOSNETTI KËRKON NGA KURTI DHE OSMANI FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, të martën ka takuar ndarazi liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ushtruesen e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani. Kosnetti në këto takime ka kërkuar që sa më shpejt të formohen institucionet e reja të dala nga zgjedhjet e 14 shkurtit. Ambasadori amerikan ka thënë se Kosovën e presin sfida urgjente IFAQE 3

AFËR 5 000 TË RINJ TË PREKUR NGA COVIDI NË KOSOVË IFAQE 6



OPINION

ALBIN KURTI DHE VJOSA OSMANI DUHET T'I JAPIN FUND GJUNJËZIMIT TË KOSOVËS DHE KËRKIMLËMOSHËS F. 8

Shkruan: Ekrem KRASNIQI, Bruksel



AKTUALE

PRESIDENTI AMERIKAN I SHKRUAN OSMANIT: MEZI PRESIM TË PUNOJMË ME QEVERINË E RE F. 5

DNV-ja: ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT, NË FRYMË DEMOKRATIKE F. 3

SHOQATA "JETIMAT E BALLKANIT" DO TË NDËRTOJË THERTORE NË VLERË 2.5 MILIONË EURO F. 10

EKONOMI



PIRAJ: DUHET TË INICIOHET REFORMA TOTALE E POLITIKAVE TATIMORE NË VEND F. 9

BQK-ja DHE POLICIA VAZHDOJNË BASHKËPUNIMIN F. 9

KULTURË

NË VEND TË PARATHËNIES F. 11

Elife LUZHA



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania nis zbatimin e karantinës nëpër hotele

LONDËR, 16 SHKURT - Udhëtarët e parë që duhet t'i nënshtrohen karantinës nëpër hotele kanë nisur të arrijnë në Mbretërinë e Bashkuar. Të gjithë qytetarët britanikë dhe ata irlandezë, si dhe ata me lejeqëndrime, që shkojnë në Britani të Madhe pasi kanë qenë në ndonjë shtet me rrezik të lartë të koronavirusit, tani duhet të vetizolohen nëpër hotele. Në listën e kuqe të 33 shteteve me rrezik të lartë përfshihen Portugalia, Brazili dhe Afrika Jugore. Kufizimet e

reja, të cilat synojnë ta ndalin përhapjen e varianteve të reja të koronavirusit në Britani, zbatohen për ata që kanë qenë në vendet e renditura në listë në 10 ditët e fundit. Ata duhet të paguajnë paraprakisht 1 750 funta për të kaluar 10 ditë nëpër hotelet e kontraktuara nga qeveria. Në këtë çmim përfshihet qëndrimi në hotel, transporti dhe testimi. Një udhëtar ka thënë për BBC-në se "ndihet keq" që do të qëndrojë i izoluar për 10 ditë. Roger Goncalves, 23-

vjeçar nga Brazili, ka thënë se ka kryer testin për koronavirus dhe ka dalë negativ. "Pse duhet të rri në dhomë për 10 ditë?". Ai ka thënë se çmimi i hotelit është "shumë i lartë" për 10 ditë, mirëpo kushtet në hotel janë të mira. Qeveria britanike ka thënë se ka arritur marrëveshje me 16 hotele deri më tani, duke siguruar 4 963 dhoma për sistem të karantinës, derisa 58 000 dhoma të tjera janë aktualisht vetëm në fazë të pritjes.



Prokurorët kërkojnë gjobë 13 000 dollarëshe për Navalyn

MOSKË, 16 SHKURT - Prokurorët rusë kanë kërkuar që kritiku i Kremlinit dhe aktivisti opozitar Aleksei Navalny të gjobitet me 950 000 rubla (13 000 dollarë) për shpifje ndaj një veterani të Luftës së Dytë Botërore, i cili ka marrë pjesë në një video promovionale të organizuar nga Kremlini. Navalny është tallur me njerëzit në atë video, duke i quajtur "tradhtarë dhe të korruptuar". Shpifja, sipas ligjit rus, është e ndëshkueshme deri me dy vjet burgim.



Veteranët e Luftës së Dytë Botërore respektohen nga shumica e rusëve dhe kritikant ndaj tyre janë të papranueshme në shoqëri. Procedurat e 16 shkurtit përbëjnë përpjekjet e fundit, të cilat për Navalny dhe aleatët e tij i konsiderojnë të motivuara politikisht dhe me qëllimin e vetëm, që ai të mbetet mbrapa grilave. Më herët gjatë këtij muaji, Navalny është dënuar me gati tri vjet burgim, pasi gjyqtari ka vendosur që ai ka shkelur pikat e një dënimi me kusht, derisa ka

qenë duke u shëruar në Gjermani si pasojë e helmimit me agjent nervor. Burgosja e Navalnyt ka nxitur protesta të mëdha në gjithë Rusinë. Shumë shtete perëndimore kanë dënuar burgosjen dhe helmimin e tij, për të cilin janë fajësuar agentët e sigurisë. Navalny dhe organizata e tij, Fondacioni Kundër-Korrupsionit, janë gjobitur edhe të kaluarën. Këto përpjekje konsiderohen tentime për t'i falimentuar anëtarët e saj.

OBSH-ja autorizon përdorimin e vaksinës "AstraZeneca"

Gjenevë, 16 shkurt - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka dhënë dritën jeshile për përdorimin emergjent të një vaccine kundër koronavirusit, të prodhuar nga kompania farmaceutike "AstraZeneca", në bashkëpunim me Universitetin e Oksfordit. Kjo është vakcina e dytë që autorizon OBSH-ja, pas autorizimit të vaksinës "Pfizer/BioNTech" në muajin dhjetor. Pritjet tani janë që vendet që kanë aplikuar për vakcina në skemën "COVAX" të nisin t'i marrin dozat e para.

COVAX është një nismë e OBSH-së, që synon t'i furnizojë me vakcina edhe vendet e varfra. "Vendet që nuk kanë pasur qasje në vakcina deri më sot do të jenë më në fund në gjendje të fillojnë t'i vaksinonjë punëtorët e tyre shëndetësorë dhe popullatat në rrezik", ka thënë Mariangela Simao, ndihmësdrejtoreshë e përgjithshme e OBSH-së për qasjen në barna dhe produkte shëndetësore. Koronavirusi ka infektuar mbi 109 milionë njerëz në të gjithë botën. Së paku 2.4 milionë prej tyre kanë

vdekur. Por, shumë vende të botës ende nuk kanë nisur programet e vaksinimit e, madje, edhe vendet e pasura po përballen me mungesa të dozave, derisa fabrikat po përpiqen ta rrisin prodhimin. Vakcina e "AstraZenecas" është miratuar tashmë në mbi 50 vende të botës, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, Indinë, Argentinën dhe Meksikën. Ajo është më e lirë dhe më lehtë për t'u ruajtur se vakcina "Pfizer/BioNTech", e cila duhet të ruhet në temperaturë në



minus 70 gradë celsius. Shumë vende në zhvillim nuk kanë frigoriferë të tillë. Për të qenë sa më efektive, edhe

"AstraZeneca", edhe "Pfizer/BioNTech" duhet të jepet në dy doza, me një diferencë kohore prej tri javësh.

Qeveria Jansha mbetet në detyrë

Lubjanë, 16 shkurt - Qeveria e kryeministrit sloven Janez Jansha ka fituar besimin në parlament, duke mos kaluar propozimi i opozitës për të caktuar Karel Erjavec mandatar për formimin e qeverisë së re. Opozita slovene, e bashkuar në

Koalicionin e Harkut Kushtetues (KUL), ka kërkuar votë mosbesimi për qeverinë Jansha dhe caktoi Erjavec kryeministër të ri. Pas një debati parlamentar njëditor në të cilin opozita e majtë-liberale akuzoi qeverinë Jansha për mosrespektim të parimeve

kushtetuese, stilin autoritar të qeverisjes, gabimet në politikën e jashtme, distancën nga shtetet qendrore të Bashkimit Evropian dhe menaxhimin e dobët të epidemisë, u mbajt votimi i fshehtë. Vetëm 53 nga 90 vetë votuan në Asamblenë

Kombëtare. Shumica e anëtarëve të koalicionit të Janshas, si dhe përfaqësuesit e Partisë Demokratike Slovene (SDS), Zmaga Jelinciq, në mënyrë demonstrative nuk votuan, duke shprehur kështu mbështetjen e padiskutueshme për qeverinë.



Pas rezultateve të zgjedhjeve të 14 shkurtit, ambasadori amerikan Philip Kosnett ka takuar Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin

Kosnetti kërkon nga Kurti dhe Osmani formimin e shpejtë të institucioneve të reja

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka takuar të martën ndarazi liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ushtruesen e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani. Kosnetti në këto takime ka kërkuar që sa më shpejt të formohen institucionet e reja të dala nga zgjedhjet e 14 shkurtit. Ambasadori amerikan ka thënë se Kosovën e presin sfida urgjente

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 SHKURT - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, është takuar të martën me Albin Kurtin në selinë e Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas një njoftimi të LV-së, ambasadori Kosnett ka uruar Kurtin për fitoren në këto zgjedhje duke i dëshiruar sukses të mëtejshëm. "Ai uroi që nga ky proces sa më parë të kemi një qeveri e parlament funksional. Kryetari Kurti e falënderoi për urimin dhe vizitën dhe ndau bindjen që shumë shpejt do ta kemi qeverinë e re dhe mundësinë për të

bashkëpunuar për projekte konkrete që ndihmojnë shtetndërtimin demokratik, zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe thellimin e marrëdhënieve bilaterale midis dy shteteve tona", është theksuar në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje.

Për takimin me Kurtin ka shkruar në "Twitter" edhe vetë ambasadori amerikan, Philip Kosnett. "I gëzuar që u takova me Albin Kurtin për ta uruar Lëvizjen Vetëvendosje për fitoren e saj dhe për të diskutuar për hapat e Kosovës në vazhdim. Nxsisim palët të punojnë shpejt për të formuar një qeveri dhe Kuvend për t'u shërbyer të gjithë

qytetarëve dhe për t'i adresuar sfidat urgjente", ka shkruar Kosnetti në llogarinë e vet në "Twitter".

Profesori universitar Blerim Latifi ka komentuar vizitën e ambasadorit amerikan Philipp Kosnett në Lëvizjen Vetëvendosje. Latifi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se nuk është e vështirë të kuptohen arsyet e vizitës së


Kosnettit në Vetëvendosje. "Kosnetti i paska shkruar në zyrë Kurtit. Nuk është e vështirë të kuptohen arsyet: deklarimet e vazhdueshme të zyrtarëve të tij se nuk do ta respektojnë marrëveshjen e Uashingtonit, së cilës, siç tanimë dihet, i qëndron prapa edhe administrata e re amerikane. Uroj që Kurti të ketë marrë mësim e të jetë imunizuar nga kjo budallaki e ushqyer vazhdimisht nga broçkullat e internacionale socialiste dhe të fillojë të sillet si kryeministër shqiptar i Kosovës e jo si militant i devotshëm i kësaj internacionaleje", ka shkruar profesor Latifi.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, të martën ka takuar edhe ushtruesen e detyrës së presidentit Vjosa Osmani. Kjo e fundit përmes një njoftimi në "Twitter" ka bërë me dije se me Kosnettin janë pajtuar që krijimi i institucioneve të reja duhet të jetë prioritet. "Ne jemi pajtuar që krijimi i institucioneve të reja duhet të jetë prioritet për të siguruar stabilitet dhe angazhim

të palëkundur për rimëkëmbje nga pandemia e koronavirusit", ka njoftuar Osmani në rrjetin social "Twitter".

Sipas të dhënave preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 14 shkurt 2021, Lëvizja Vetëvendosje, e udhëhequr nga Albin Kurti, ka fituar rreth 48 për qind, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me 17.35 për qind. E treta është radhitur Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.18 për qind dhe në vendin e katërt është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.42 për qind, kurse Nisma Socialdemokrate nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor prej pesë përqindësh.

Ende nuk ka një datë të saktë se kur do të nisë procesi i numërimit të votave të ardhura me postë nga diaspora në Kosovë. Përveç votave nga diaspora, KQZ-ja nuk ka nisur as procesin e numërimit të votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta. Për zgjedhjet e 14 shkurtit, të drejtë vote kanë pasur 1 794 862 persona.



DnV-ja: Zgjedhjet e 14 shkurtit, në frymë demokratike

PRISHTINË, 16 SHKURT (ER) - Rrjeti i organizatave joqeveritare Demokracia në Veprim (DnV) ka vlerësuar se zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit janë organizuar në përputhje me të gjitha standardet demokratike. "Dita e zgjedhjeve, respektivisht procesi i votimit dhe numërimit, në përgjithësi është zhvilluar i qetë, i rregullt, pa ndonjë parregullsi serioze që do të mund të ndikonte në integritetin e procesit zgjedhor. Sidoqoftë, dita e zgjedhjeve është shoqëruar me disa parregullsi të

izoluara, të cilat janë evidentuar edhe gjatë cikleve të mëparshme zgjedhore. Publikimi i rezultateve preliminare dhe daljes në zgjedhje brenda një periudhe të shkurtër kohore nga KQZ-ja ka ndikuar në rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së publikut në zgjedhje. Qytetarët e Kosovës dëshmuar një kulturë të lartë demokratike duke dalë në masë të konsiderueshme për të votuar, përkundër motit të keq dhe situatës me pandeminë", ka thënë në një konferencë për media Eugen Cakolli nga DnV-ja. Sipas tij,

subjektet politike garuese, përmes pranimit dhe respektimit të vullnetit qytetar, menjëherë pas publikimit të rezultateve, kanë kontribuar në avancimin e vlerave demokratike të zgjedhjeve dhe besueshmërisë së qytetarëve në to. "Ajo çfarë bie në sy si fenomen në këto zgjedhje është, bazuar në rezultatet preliminare, humbja e disa subjekteve politike tradicionale nga radhët e komuniteteve jo-shumicë, sidomos nga radhët e komunitetit boshnjak dhe ai rom. Te subjektet e reja



fituese vërehet elektorat i koncentruar dhe numër i pazakontë i votave të fituara në zonat e banuara me shumicë serbe, sidomos në

Mitrovicë të Veriut dhe Graçanicë, ku përgjithësisht nuk ka përqendrim të madh demografik të komuniteteve respektive", ka thënë Cakolli.



GJYKATA SPECIALE KA MBAJTUR KONFERENCËN E TRETË STATUSORE
NDAJ THAÇIT, VESELIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT

Mbrojtja e ish-drejtuësve të UÇK-së: Prokuroria po na vështirëson hetimet

Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, është ankuar se prokuroria po ua vështirëson hetimet. Avokatët kanë kërkuar që prokuroria ta dorëzojë sa më shpejt dosjen paraprake të lëndës në mënyrë që ata të mund të përgatiten për hetimin. Prokuroria ka bërë me dije se dëshmitarët janë arsyeja kryesore që dorëzimi i dosjes paragjyqësore apo paraprake duhet të lidhet me datën e gjykimit. Ndërsa mbrojtja ka vlerësuar se frikësimi i dëshmitarëve është slogan dhe se nuk ka të bëjë me realitetin

Ai ka deklaruar se ka frikë se nëse dosja paraprake nxirret më herët sesa data e nisjes së gjykimit do të mund të përdoren informacionet që përmban ajo për t'i frikësuar dëshmitarët. Prokurori ka theksuar se për të zvogëluar një rrezik të tillë janë vendosur masa mbrojtëse por, sipas tij, edhe me këto masa nuk eliminohet komplet rreziku i frikësimit të dëshmitarëve. "Është e rëndësishme që t'i jepet mbrojtjes kohë dhe burimet që të përgatitet për gjykim. Është në interesin tonë dhe të mbrojtjes", është shprehur ai, duke shtuar se mbrojtja po përpiket ta vonojë këtë proces. "Unë kam frikë se mbrojtja po përpiket ta vonojë këtë çështje dhe do ta realizojë këtë nëse vazhdon të veprojë kështu", ka thënë Smith. Ai ka deklaruar se Zyra e Prokurorit të Specializuar është për një gjykim sa më të shpejtë dhe data e nisjes së gjykimit duhet të lidhet me dorëzimin e dosjes paraprake. Ndaj pretendimeve të prokurorit për frikësim të dëshmitarëve ka reaguar avokati David Hooper, i cili në Dhomat e Specializuara të Kosovës mbron Hashim Thaçin. Sipas tij, pretendimet e prokurorit nuk kanë të bëjnë me realitetin. "Frikësimi i dëshmitarëve është slogan, s'ka

të bëjë me realitetin e çështjes. Jo të gjithë prej tyre kanë pasur përvojat që i tha Smithi. I nderuar gjyqtar, jam falënderues që ngritët kartonin e verdhë sa i përket datës së gjykimit, që kjo të mos diskutohet", ka thënë Hooper.

Mospajtime edhe për nxjerrjen e materialeve

Në nisje të kësaj konference, Prokuroria e Specializuar ka deklaruar se është duke vazhduar nxjerrjen e materialeve, përfshirë edhe ato shfaqësuese. "Në lidhje me rendin 102 konfirmoj se materialet e fundit janë nxjerrë më 12 shkurt me paketën 21 dhe janë nxjerrë të gjitha që nga konferenca e fundit. ZPS ka nxjerrë dy grupe të materialeve. Gjithashtu, më 5 shkurt ne parashtruam një kërkesë për masa mbrojtëse lidhur me rregullin 102, siç është thënë në parashtrimin tonë. Materialet po punohen në mënyrë sistematike. Kanë mbetur edhe disa dhe do të bëhet nxjerrja në javët dhe muajt e ardhshëm", ka thënë një prokuror e ZPS-së. Më tutje, prokurorja ka thënë se kanë shumë dëshmitarë, duke shtuar se nuk është e përcaktuar

EPOKA ERE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 16 SHKURT - Pala mbrojtëse e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ka kritikuar të martën prokurorinë se nuk po përmbush detyrimet e veta. Gjatë konferencës së tretë statusore, avokatët e të akuzuarve kanë kërkuar që Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ta dorëzojë sa më shpejt dosjen paraprake të lëndës, në mënyrë që ata të mund të përgatiten për hetimin. Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka kërkuar që dorëzimi i kësaj dosjeje të ndodhë në fillim të prillit. "Ajo që thotë Prokuroria është se do t'i marrim këto udhëzime kur ata ta dorëzojnë dosjen

paragjyqësore. Neve na duhet ajo më herët. Sugjeroj, z. gjykatës, që të urdhërohet një datë e dorëzimit nga Prokuroria për dosjen paragjyqësore në fillim të prillit. Të dorëzohet bashkë e të mbushen ato boshllëqe që Prokuroria po i lë fillimisht në mënyrë që t'i nisim hetimet tona. Prokuroria po na vë në pozitë që të hyjmë në pyll pa dalje", ka thënë Emmerson. Por, prokurori i specializuar, Jack Smith, ka bërë me dije se viktimat apo dëshmitarët janë arsyeja kryesore që dorëzimi i dosjes paragjyqësore apo paraprake duhet të lidhet me datën e gjykimit. Në adresimin e tij para Dhomave të Specializuara, prokurori Smith ka deklaruar se frikësimi i dëshmitarëve është realiteti i kësaj çështjeje. "Është e rëndësishme t'i jepet mbrojtjes koha dhe burimet për t'u

mbrojtur, por kjo gjykatë duhet të ketë konsiderata të tjera për të marrë parasysh kur caktohet data e gjykimit dhe e dorëzimit të dosjes paraprake. Kemi një orë e gjysmë këtu dhe nuk është përmendur realiteti i frikësimit të dëshmitarëve. Është realiteti i kësaj çështjeje e do të mbetet", ka thënë Smith, duke shtuar se nxjerrja komplet e dokumenteve do t'i rrezikonte dëshmitarët. "Është fakt që nëse ka hendek të madh mes nxjerrjes së të gjitha dokumenteve e datës së gjyqit, atëherë do të rrezikohen dëshmitarët e kjo nuk është folur. Janë vendosur masa mbrojtëse, janë bërë redaktime, është zvogëluar rreziku, por nuk është eliminuar tërësisht. Duhet t'i themi të gjitha këto pasi, nëse lejohet kohë e madhe me muaj, atëherë nuk do t'u shërbejnë dëshmitarëve e viktimave", është shprehur Smith.

nëse do t'i përdorin të gjithë këta persona në gjyq. Por, avokati i Thaçit, David Hooper, ka deklaruar se deri tani janë informuar për 124 dëshmitarë, të cilët prokuroria ua ka identifikuar vetëm me pseudonime. Ai ka kërkuar nga prokuroria që t'ua dorëzojë listën e dëshmitarëve që do të përdorë në gjyq, në mënyrë që mbrojtja t'i kryejë hetimet e duhura. "Në lidhje me nxjerrjen e materialeve ka pasur disa vështirësi konkrete të cilat kryesisht janë trajtuar nga SPS-ja, kur u vu në dukje, por mbetet ai që unë e quaj problem të përgjithshëm. Mënyra se si sistemi me anë të të cilit nxirren materialet nuk është i dobishëm, pra mund të them se nga sistemet e nxjerrjes së materialeve me të cilën kemi punuar në gjykatat e tjera, ky sistem këtu është më pak i dobishëm dhe është problem", ka thënë Hooper. Ai ka treguar se

në këto raste ka 124 dëshmitarë, ku shumica prej tyre njihen me pseudonime, por që nuk janë dhënë përmbledhje lidhur me ta. "Në këto raste ka 124 dëshmitarë që janë bërë të njohur, shumica e tyre, siç e dini, me pseudonime. Nuk na është dhënë ndonjë detaj. Nuk kemi as edhe pesë rreshta lidhur se me çfarë do të diskutojnë këta dëshmitarë. Asnjë dëshmitar nuk është bërë i ditur bashkë me provat shoqëruese, sepse kur ka një dëshmitar duhet të ketë edhe prova që lidhen me ata dëshmitarë e jo të na lihet neve ta lidhim dëshmitarin me dokumente të caktuara. Mungojnë hollësitë në lidhje me materialin, mungojnë hollësitë dhe SPS-ja vazhdon të veprojë kështu sepse kështu e thonë në argumentet e tyre. Mungojnë tabelat lidhëse. Dhe janë disa pika që kur bëhen bashkë krijojnë problem", ka thënë avokati i Thaçit.

Kurse avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se prokuroria i ka varrosur provat relevante në një mal provash jorelevante. Ai është ankuar se ka një kaos sa iu përket nxjerrjeve të materialeve, duke thënë se prokuroria duke nxjerrë materiale voluminoze dhe duke mos treguar se cilat dëshiron t'i përdorë, po ia pamundëson mbrojtjes që të përgatitet për gjykim. Edhe mbrojtja e Rexhep Selimit dhe ajo e Jakup Krasniqit është deklaruar e pakënaqur me mënyrën se si prokuroria po nxjerr materiale për këtë rast gjyqësor. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi nuk kanë marrë pjesë fizikisht në këtë seancë, por e kanë ndjekur përmes video-lidhjes. Konferenca statusore, apo konferenca mbi ecurinë e çështjes, është thirrur nga gjykatësi i procedurës paraprake dhe ajo ka për qëllim organizimin e shkëmbimeve ndërmjet palëve. Gjykata

Speciale në nëntor të vitit të kaluar ka ngritur aktakuzën kundër ish-krerëve të UÇK-së. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi, të cilët gjenden në paraburgim në Hagë, në seancë e parë janë deklaruar të pafajshëm. Sipas aktakuzës, Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi dyshohen për veprat penale që kanë të bëjnë me krime

luftë, ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe krime kundër njerëzimit, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, zhdukje me forcë të personave dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit 1999.

Krasniqi i reagon ashpër prokurorit Smith: Në emër të popullit flasim ne

Ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, i ka reaguar ashpër prokurorit Jack Smith, duke i thënë që të mos flasë në emër të qytetarëve të Kosovës. "Reagimi im në fjalën e prokurorit Smith, kur foli në emër të popullit të Kosovës. Në emër të qytetarëve të Kosovës, në emër të popullit të Kosovës, mund të flasim ne përfaqësuesit e tij. Unë 45 vjet të jetës i kam angazhuar për lirinë, drejtësinë dhe çlirimin e kombit tim nga robëria. Në zgjedhjet e vitit 1992 kam qenë i zgjedhur deputet në Kuvendin e Kosovës që regjimi kriminal i Serbisë nuk e lejoi të konstituohet. Pas luftës çlirimtare kam qenë në të gjitha legjislaturat, deri në atë të vitit 2014, përfaqësues i qytetarëve të Kosovës. E kisha lutur prokurorin që, nëse duhet të flasë në emër të

dikujt, ose duhet të flasë në emër të krimeve të pretenduara, le të bëhet mbrojtës i politikave të krimit dhe gjenocidit që regjimi i Serbisë ka përdorur kundër kombit tim nga viti 1876-78 të shekullit XIV", ka thënë Krasniqi, duke treguar se kush mund të flasë në emër të popullit. "Prandaj në emër të popullit tim, në emër të kombit tim, në emër të luftës dhe sakrificave të mëdha të vendit, flasim ne përfaqësuesit e tij e jo ata që tentojnë ta dënojnë luftën shumëvjeçare të kombit tim, në mënyrë të veçantë luftën e fundit të popullit tim për liri, drejtësi, pavarësi e për shtetndërtim, për të cilën e kemi fituar mbështetjen ndërkombëtare. E kemi çliruar Kosovën e Kosova sot është shtet i pavarur, i lirë nga ai regjim", ka thënë Krasniqi.

Mbrojtja e Thaçit cakton një hetues nga Zvicra për t'i kryer hetimet

Avokati i Hashim Thaçit, David Hooper, ka hedhur poshtë pretendimet e Prokurorisë së Gjykatës Speciale se, kinse, mbrojtja është duke dëshiruar ta vonojë çështjen. "Nuk ka absolutisht asnjë lloj sugjerimi për vonimin e procesit gjyqësor nga ana e mbrojtjes dhe nuk e kuptoj se çfarë fitimi mund të ketë mbrojtja nga kjo dhe nuk e di pse prokuroria e pretendon

një gjë të tillë deri në një masë", ka thënë Hooper. Ai ka bërë me dije se ende nuk kanë filluar hetimet. "Personalisht do të doja të them që ne ende nuk i kemi filluar hetimet dhe përgatitjet për to. Unë personalisht nuk i shoh hetimet që mund të fillojnë përpara prillit dhe mund të them se edhe në qoftë se nuk do të ishte situata e Covid-19, do të ishte prapë situata e vështirë.

Covid-19 ka vështirësuar shumë qasjen për ne. Thaçi pret që unë të vij në Hagë, dhe unë pres që të vij në fund të këtij muaji", ka thënë ai. Hooper ka treguar se ka caktuar një hetues që jeton në Zvicër. "Në fillim të këtij muaji kemi caktuar dikë që të funksionojë si hetues kryesor. Ai është një person që jeton në Zvicër dhe i ka vështirësitë e veta", ka deklaruar ai.

Presidenti amerikan i shkruan Osmanit: Mezi presim të punojmë me qeverinë e re

Prishtinë, 16 shkurt (ER) - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, i ka dërguar një telegram urimi ushtrueses së detyrës së presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, për 13-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Bideni në telegramurimin drejtuar Osmanit ka përmendur edhe çështjen e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se kjo marrëveshje duhet ta ketë në qendër njohjen e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Populli amerikan iu bashkohet urimeve të mia për ju dhe miqtë tanë në Kosovë në 13-vjetorin e pavarësisë. Lidhjet ndërmjet popujve tanë mbeten të forta, bazuar në një përkushtim të përbashkët për zhvillimin e vazhdueshëm të Kosovës si dhe forcën tuaj të qëndrueshme si një vend sovran, i pavarur, shumetnik dhe demokratik. Ne mezi presim të punojmë me



qeverinë e ardhshme për ta çuar Kosovën përpara në

rrugën evropiane. Ka shumë punë për të bërë, përfshirë

marrëveshjen gjithëpërfshirëse të normalizimit të

marrëdhënieve me Serbinë që në qendër e ka njohjen e ndërsjellë, me të cilën forcohet sundimi i ligjit, përballimi i pandemisë globale Covid-19 dhe nxitja e rritjes ekonomike që mundëson një të ardhme të prosperuar për të gjithë qytetarët e Kosovës", është thënë në telegramurimin e Bidenit.

Më tutje, ai ka thënë se ShBA-ja mbetet mike e përkushtuar e Kosovës. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbetet partner dhe mik i përkushtuar i Kosovës në këto përpjekje. Për mua personalisht, Kosova vazhdon të mbajë një vend të veçantë në familjen Biden, në shenjë respekti gjatë kohës kur djali ynë i ndjerë, Beau Biden, punoi për t'i siguruar paqen, drejtësinë dhe shtetin e së drejtës për të gjithë qytetarët e Kosovës", është në këtë telegram urimi.

Projekti i financuar nga ShBA-ja ndihmon në plotësimin e kriterëve për kthimin e AKA-së në ENQA


PRISHTINË, 16 SHKURT (ER) - Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe WUS Kosova kanë mbajtur të martën konferencën virtuale me temë "Sfidat e zbatimit të standardeve dhe udhëzuesve për sigurim të cilësisë të zonës evropiane të arsimit të lartë, nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë", financuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, përmes Programit të Granteve për Mbështetje të Universitetit.

Profesori Dukagjin Zeka, anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, ka thënë se rikthimi i AKA-së në ENQA është një nga prioritetet kryesore. "Agjencia e Akreditimit gjatë vitit të fundit ka miratuar një plan dinamik për zbatimin e të gjitha kriterëve për kthim në ENQA. Është bërë një punë e madhe për arritjen e këtyre objektivave. Ne shpresojmë që shumë shpejt do të krijohen institucionet e reja të cilat do ta miratojnë Ligjin për AKA-në, si një nga kriteret kryesore për plotësimin e këtyre standardeve", ka thënë Zeka.

Ndërsa Naim Gashi, drejtor i

Agjencisë së Akreditimit, ka thënë se e gjithë energjia e stafit të AKA-së është përqendruar në përbushjen e rekomandimeve të raportit të ENQA-s, në mënyrë që sa më shpejt të bëhet rikthimi në këtë organizatë ndërkombëtare. Gashi e ka falënderuar donatorin, Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, për financimin e këtij projekti, por edhe disa projekteve të tjera që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë për transparencë dhe pavarësi institucionale. Ai ka thënë se zbatuesi i këtij projekti, WUS Kosova, ka bërë një punë shumë profesionale për ta përkrahur Agjencinë për plotësimin e kriterit më të vështirë të ENQA-s, e ky është krijimi i metodologjisë për analiza tematika.

Në anën tjetër, Luljeta Aliu nga WUS Kosova ka thënë se garantimi i pavarësisë së AKA-së është një nga kriteret kryesore, duke u bazuar në "Standardet dhe udhëzuesin për sigurimin e cilësisë në zonën evropian të arsimit të lartë". Ajo ka thënë se



për zbatimin e këtij projekti janë të angazhuar ekspertë eminentë vendorë dhe ndërkombëtarë, ndërsa kjo konferencë do ta mundësojë marrjen e mendimeve të të gjithë aktorëve në arsimin e lartë në Kosovë. Qëllimi i kësaj konference është që së bashku me përfaqësuesit

të institucioneve të arsimit të lartë, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, të diskutohen sfidat e zbatimit të proceseve të sigurimit të cilësisë në Kosovë bazuar në "Standardet dhe udhëzuesin për sigurimin e cilësisë në zonën evropian të arsimit të lartë".

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin: rektorë, pro-rektorë, profesorë, studentë, përfaqësues të Unionit të Studentëve të Kosovës, udhëheqës të programeve studimore, personeli i zyrave të cilësisë të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë etj.

Afër 5 000 të rinj të prekur nga Covidi në Kosovë

PRISHTINË, 16 SHKURT - Në Kosovë rreth 5 000 persona nga moshë zero deri në 19 vjeç janë prekur nga Covid-19. Kjo sëmundje vazhdon t'i prekë kryesisht personat e rritur e më pak fëmijët. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar për "Radion Evropa e Lirë" se nga moshë zero deri në 9 vjeç janë infektuar me koronavirus 1 050 fëmijë, kurse nga moshë dhjetë e deri në 19 vjeç janë regjistruar 3 631 raste me Covid.

Drejtoresha e Klinikës së Pediatriisë, Drita Telaku-Qosaj, ka thënë për "Rel" se që nga paraqitja e rasteve të para me koronavirus në Kosovë, në klinikën që ajo drejton janë trajtuar afërsisht 100 fëmijë që janë infektuar me këtë virus. Ajo tha se në repartin e dedikuar për rastet me Covid-19, një fëmijë ka humbur betejën me këtë sëmundje. "Prej fillimit të pandemisë nuk ka qenë numri shumë i madh i fëmijëve që kanë pasur nevojë për hospitalizim. Deri tash kemi pasur gjithsej 85 fëmijë që kanë pasur nevojë për hospitalizim. Mirëpo, një numër i madh i fëmijëve janë mjekuar në mënyrë ambulatorë", ka thënë Telaku-Qosaj, duke shtuar se nga fëmijët që kanë qenë të shtrirë, ka pasur edhe fëmijë me një



gjendje klinike pak më të rëndë. "Fatmirësisht të gjithë e kanë tejkaluar. Në gjendje klinike pak më të rëndë kanë qenë fëmijët të cilët kanë pasur disa sëmundje kronike, bashkëshoqëruese nëse mund të them, dhe vetëm një nga ta e kemi humbur", shtoi ajo. Nxënësit po vijnë në mësimin në shkollat e Kosovës, por gjithmonë duke respektuar rekomandimet për mbrojtje nga Covid-19 të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Në rast se një nxënës i një klase rezulton pozitiv me

koronavirus, e gjithë klasa për dy javë izolohet dhe kalon në mësimin online. Inspektorati në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës bëri me dije se vetëm në gjysmëvjetorin e dytë, që ka nisur më 18 janar, janë infektuar 189 mësimdhënës në shkollat e Kosovës. Kurse që nga fillimi i viti shkollor 2020/2021, me koronavirus janë infektuar 2 641 mësimdhënës. Inspektorati i Ministrisë së Arsimit nuk ka dhënë informacione se sa nxënës janë infektuar me këtë virus. Të dhëna për infektimin e

nxënësve nuk ka publikuar as Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë me dije se aktualisht vetëm në një shkollë fillore në Komunën e Vushtrrisë, në fshatin Nedakoc, po zhvillohet mësimin online për shkak të infektimit të pesë mësimdhënës me koronavirus. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Kosovës, Ymret Reshiti, ka thënë për "Rel" se gjendja në shkollat e Kosovës, sa i takon pandemisë, është stabile. "Ka raste të koronavirusit, por jo në

përmasa të mëdha, kurse sa iu takon rasteve dhe testeve, sipas informacioneve zyrtare që i kemi, vazhdojnë të bëhen testet sipas strategjisë që e ka Ministria e Arsimit në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit, do të thotë atëherë ku ka nevojë", ka thënë Reshiti.

Edhe Rrahman Jashari nga Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK) ka theksuar se gjendja në shkollat e Kosovës është e mirë sa i përket pandemisë. "Është e natyrshme që në këtë situatë, aty ku paraqiten raste me Covid-19, të bëhen testet. Shkollat janë duke vepruar sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe manualit të përgatitur për pandeminë", ka thënë Jashari. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka thënë se fëmijët deri tash e kanë përjetuar sëmundjen Covid-19 kryesisht me simptoma të buta. Sipas Qendrës Evropiane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve kjo ndodh për faktin se shumica e fëmijëve nuk zhvillojnë simptoma të sëmundjes. Madje edhe transmetimi i virusit nga një fëmijë në një fëmijë tjetër është i vogël.

Sot 13 vjet nga shpallja e pavarësisë së Kosovës



VITE TË PAVARËSISË
YEARS OF INDEPENDENCE
GODINE NEZAVISNOSTI

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË 16 SHKURT - Republika e Kosovës sot (e mërkurë) shënon 13-vjetorin e pavarësisë të shpallur më 17 shkurt të vitit 2008 dhe të njohur nga 117 shtete. Institucionet e Kosovës për këtë ditë kanë paraparë aktivitete të ndryshme. Në orën 8:00 para objektit të qeverisë do të ngrehet flamuri shtetëror nga Garda Ceremoniale e FSK-së, ku do të jenë të pranishëm ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë Avdullah Hoti dhe përfaqësues ndërkombëtarë. Ndërkaq në

orën 9:00 në Velani, liderët shtetërorë do të bëjnë homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova. Po ashtu në orën 10:00 në Prekaz liderët shtetërorë do të bëjnë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari". Gjithashtu, më 17 shkurt, në orën 10:00, në të gjitha komunitatet e Kosovës do të bëhen homazhe te varrezat e dëshmorëve.

Ndërkaq në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, në orën 12:00, do të mbahet manifestimi qendror, ku do të jenë të pranishëm ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë Avdullah Hoti dhe përfaqësues të tjerë të

institucioneve.

Më 17 shkurt, në orën 18:00, ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, do ta organizojë pritjen shtetërore për 13-vjetorin e pavarësisë së Kosovës.

Ndërkaq në orën 20:00, në "Klan Kosova", nën përkujdesjen e kryeministrit Avdullah Hoti, do të mbahet koncerti recital i këngëtarit Ilir Shaqiri.

Dizajnuet i flamurit dhe i stemës së Kosovës është Muhamer Ibrahim.

Shyqri Nimani për 16 orë pa ndërprerë ka kaligrafuar në pergamenë Deklaratën e Pavarësisë.

Të parët që nënshkruan Deklaratën e Pavarësisë së

Kosovës ishin: presidenti Fatmir Sejdiu, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, si dhe kryeministri i vendit, Hashim Thaçi.

Shtetet e para që njohën Kosovën shtet pas shpalljes së pavarësisë ishin: Kosta Rika, ShBA, Franca, Afganistani, Shqipëria, Turqia, Britania e Madhe etj.

Pergamena e vjetër 200-vjeçare në të cilën është nënshkruar Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, gjendet në zyrën e kryetarit të Kuvendit. Përveç pergamenës, aty gjenden edhe lapsi me të cilin janë vënë nënshkrimet, listat e nënshkrimeve të deputetëve

pjesëmarrës në seancë, si dhe flamuri i vendosur në seancën e shpalljes së pavarësisë. Muzeu i Londrës ishte ai që ia fali Kosovës pergamenën për shpalljen e pavarësisë. Flamujt e parë të Republikës së Kosovës ishin shtypur në Turqi. Himni i Kosovës, i kompozuar nga kompozitori Mendi Mengjiqi, për herë të parë ishte intonuar në seancën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Yjet e bardhë në flamurin e Kosovës simbolizojnë komunitetet e ndryshme që jetojnë në Kosovë, harta e verdhë simbolizon pasurinë e Kosovës, ndërsa ngjyra e kaltër simbolizon Evropën.

Tre të vdekur, 316 të shëruar dhe 249 raste të reja me Covid



PRISHTINË, 16 SHKURT (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë tre persona për shkak të infektimit me Covid-19. Po ashtu, ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 316 persona nga Covidi dhe janë paraqitur 249 raste të reja, raporton "Epoka e re". "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 2 868 mostra të marra

nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 249 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 3 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë 2 raste (42, 86 vjeç) dhe Vushtrri 1 rast (76 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 64 768 raste nga 271 493 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 1 548 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 316 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 56 344 raste, kurse

numri i rasteve aktive është 6 876", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve sipas secilës komunë. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 116 raste, Prizren 44 raste, Podujevë 12 raste, Ferizaj 11 raste, Fushë-Kosovë 9 raste, Gjilan 9 raste, Lipjan 8 raste, Pejë 7 raste, Deçan 6 raste, Skenderaj 5 raste, Gjakovë 4 raste, Suharekë 3 raste, Vushtrri 3 raste, Drenas 2 raste, Kaçanik 2 raste, Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Shtime dhe Viti", ka njoftuar IKShPK-ja.

Kosova dhe Jemeni do t'i forcojnë marrëdhëniet diplomatike

PRISHTINË, 16 SHKURT (ER) - Ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka bërë me dije se ka zhvilluar takim virtual me ministrin e ri të Jashtëm të Jemenit, Ahmad Awad bin Mubarak. Ajo ka thënë se me ministrin e Jashtëm të Jemenit diskutuan për vazhdimin e marrëdhënieve të mira mes

dy vendeve dhe për thellimin e mëtejshëm të tyre përmes forcimit të kontakteve diplomatike. "I shpreh ministrit Mubarak se Kosova ndjek me vëmendje zhvillimet në Jemen dhe qëndron përkrah politikave rajonale të aleatit tonë të përbashkët ShBA-së. E falënderova homologun nga Jemeni për mbështetjen e vazhduar ndaj forcimit të

subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Me ministrin Mubarak konfirmuam se Kosova dhe Jemeni do ta vazhdojnë bashkëpunimin e afërt dhe forcimin e miqësisë mes popujve tanë, duke hapur një epokë të re në marrëdhëniet mes dy vendeve tona dhe me vendet anëtare të Ligës Arabe", ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla.



Albin Kurti dhe Vjosa Osmani duhet t'i japin fund gjunjëzimit të Kosovës dhe kërkimlëmshës?



Shkruan: Ekrem KRASNIQI, Bruksel

Janë të panumërta rastet kur Kosova është trajtuar nga Bashkimi Evropian (BE), nga vendet e saj anëtare dhe nga administratat e deritashme e ShBA-së, rast humanitar, përkatësisht një vend dhe popull që kënaqet me lëmshë vetëm sa për të mbijetuar. Pushtetarët e deritashëm ia kanë krijuar një imazh të këthillë Kosovës dhe ajo vazhdon që të trajtohet nga krejt perëndimorët dhe qeveritë e tyre. Shikojeni rastin më drastik dhe më të turpshëm nga ana e BE-së për çështjen e vizave. Përkundër këtij poshtërimit që vendet e BE-së po ia bëjnë Kosovës, pushtetarët e deritashëm kanë ardhur këtu në Bruksel për të dialoguar me ish-ministrin e Sllobodan Millosheviqit, Aleksandar Vuçiq, pa hezituar dhe pa asnjë kusht paraprak që do të duhej përmbushur Serbia dhe vetë qeveritë e vendeve anëtare të BE-së.

PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja e kanë krijuar dhe forcuar këtë imazh dhe trajtim të këthillë ndaj Kosovës sidomos që nga viti 2011 kur janë futur në dialog me Serbinë pa asnjë rezistencë dhe parakusht. Në të njëjtën kohë krejt Kosova po vazhdon që të gënjejhet nga BE-ja për vizat, edhe përkundër nënshkrimit kontrovers për kufirin me Malin e Zi.

Çka tash e tutje, pas fitores së LV-së?

Kreativiteti dhe kundërsulmet duhet të fillojnë nga vetë Kosova, së pari për ta ndryshuar për 180 shkallë imazhin e hupësit të gjunjëzuar.

Së pari duhet ndërruar qasjen ndaj dialogut, sepse pushteti në Serbi është në komoditet, aktualisht në dialog të ndërmjetësuar nga BE-ja, sepse nuk ka presion të brendshëm publik në Serbi për ta njohur Kosovën, meqë hyrja e Serbisë në BE nuk mund të ndodhë para pesë vjetësh (për arsye teknike të kohëzgjatjes së bisedimeve të anëtarësimit në BE). Kosova nuk duhet t'i bëjë asnjë lëshim/kompromis Serbisë për privilegje të posaçme komunave serbe, të synuara nga Beogradi dhe BE-ja përmes Asociacionit (AKS), i cili është një skenar i vonuar i tipit të Bosnjës që do të shndërrohet përsëri në kërcënim (të vonuar në kohë) për nga brendia e pjesës veriore të Kosovës pasi Serbia të

anëtarësohet në BE.

Kosova i ka ligjet tashmë për OJQ dhe shoqata/asociacione. Ajo nuk duhet që të krijojë ligje e statute të veçanta për t'i hapur derën pushtetit të tretë për pakicën serbe, sado që ato do të tentohet nga perëndimorët të kamuflohen e të paktohen kinse si jo të rrezikshme për funksionimin e shtetit të Kosovës.

Nënshkrimet e 2013-s nga Hashim Thaçi dhe 2015-s nga Isa Mustafa për AKS-në janë bërë kur kryetari i tashëm i ShBA-së, Joe Biden, ishte njeriu i dytë në Shtëpi të Bardhë. Edhe ndryshimi i mbrapshtë dhe selektiv i Kushtetutës dhe Ligjit për Gjykatën Speciale në Hagë janë bërë atëherë kur Bideni dhe njerëzit e tij të tashëm ishin në pushtet në Uashington.

Strategjia e ngadalësimit të negociatave me Serbinë

Imaginojeni presionin e brendshëm publik ndaj pushtetit në Serbi kur vendi fqinj të ketë hapur dhe mbyllur 34 kapitujt e t'i ketë mbetur vetëm kapitulli 35 (Kosova), përkatësisht njohja e pavarësisë së Kosovës me kufijtë e tashëm të saj.

Opinionin publik në Serbi me përmblylljen e kapitullit 34 do të jetë virtualisht në BE dhe me mendje tek anëtarësimi, aty duke pritur hyrjen praktike brenda në shtëpinë e BE-së. Në këtë skenar, i njëjti popull serb në Serbi do ta shohë derën e hapur për hyrje në BE, por pragun nuk do të mund ta kalojë për shkak të pengesës Kosovë që ia bllokoi derën. Ky moment krijon atmosferën e presionit ndaj qytetarëve serbë dhe ndaj pushtetit në Serbi të llojit: BE apo Kosovë.

Për këtë arsye strategjia që duhet të ndërtojë Kosova deri në arritjen e këtij momenti në relacionet BE - Serbi duhet që të fillojë me zvarritjen e dialogut në maksimum.

a) Së pari ajo (Kosova) nën arsyetimin e 'confidence building measures' (ndërtimit të masave të besimit) ndaj BE-së duhet që ta kufizojë dialogun (e të kërcënojë që ta pezullojë hapjen e temave të reja nga ato të tashmet që i ka hapur Avdullah Hoti: personat e zhdukur; të zhvendosurit dhe çështjet financiare/ekonomia derisa BE-ja nuk ia heq vizat, përkatësisht derisa qytetarët e Kosovës të fillojnë të udhëtojnë lirshëm nëpër Zonën Shengen të BE-së.

b) Me punën dhe realizimin e takimeve në Bruksel, rreth vetëm këtyre tri temave të dy vendet ndërkohë do të krijojnë po ashtu 'masa të besimit të ndërsjellët', para se të pihen kushtet për marrëveshje përfundimtare

eventuale me Serbinë.

c) Kur të binden vendet e BE-së për 'kundërsulmin' dhe kokëfortësinë e Kosovës, të menduarit brenda BE-së do të mund të fillojë të ndryshojë dhe mund të ketë lëvizje për liberalizim të vizave e kështu gradualisht edhe për ndërrimin e trajtimit të Kosovës si rast humanitar.

Tentativat e BE-së për hapjen e temave të tjera, sidomos të AKS-së, duhet të marrin përgjigje të prerë kundër nga Kosova për suspendim total të dialogut deri në liberalizim të vizave.

Kundërsulmi ndaj Serbisë dhe Aleksandër Vuçiqit duhet që të përqendrohet në insistimin për drejtësi në Gjykatën Speciale për krimet e luftës që i ka bërë Serbia ndaj shqiptarëve të Kosovës duhet të jetë parakusht për hapet e më tutjeshëm rreth dialogut. d) Kosova duhet t'i plotësojë/qartësojë/riformulojë disa nene të ligjit për Gjykatën Speciale, për ta obliguar qartësisht kryeprokurorin Jack Smith për t'u marrë pa vonesë me forcat serbe dhe pjesëtarët e saj të viteve 1998-'99 dhe personalisht edhe me Aleksandër Vuçiqin për krimet e luftës në Kosovë.

Futja në rend dite të Kuvendit të Kosovës të kësaj kërkesë, së pari duhet të fillojë me mobilizimin e publikut, përkatësisht të familjarëve të viktimave anekënd Kosovës, për t'i bërë ballë dhe zmbarsur presionin e ambasadorëve perëndimorë për plotësimin/qartësimin e ligjit për Gjykatën Speciale.

e) Vuçiqi, Ivica Daçiçi dhe të tjerë si ata duhet që të sqarohen para publikut kosovar, atij evropian dhe të ShBA-së dhe sidomos vetë kryeprokurorin Jack Smith atje në Hagë, për rolin e tyre në regjimin e Millosheviqit për krimet e shumta ndaj shqiptarëve. f) Pas liberalizimit të vizave Kosova duhet të aplikojë menjëherë për anëtarësim në BE; dhe sidomos përgjatë dialogut, edhe pse BE-ja

do ta kundërshtojë aplikimin duke u thirr në aspektet legale kushteve të zgjerimit të BE-së.

Ky aplikim duhet të jetë edhe testim i krejt BE-së dhe 27 vendeve anëtare të tij për premtimet për 'integritet evropian'. Marrja apo mosmarrja e statusit të vendit kandidat, apo refuzimi i trajtimit të kërkesës së Kosovës për anëtarësim pa marrëveshje me Serbinë dhe pa njohje nga 5 shtetet që nuk po e njohin Kosovën, do ta demaskonte dhe qartësonte situatën e premtimeve dhe sidomos pozicionin e 5 vendeve të BE-së ndaj Kosovës dhe fatit të saj për hyrje në BE, në rast se ka më vonë marrëveshje finale me Serbinë.

Kjo është 'the big confidence building measure' (ndërtimi i masës së madhe të besimit) midis BE-27 dhe Kosovës dhe do të zinte pisk krejt Brukselin, Berlinin, Parisin dhe kryeqytetet e tjera të BE-së sepse do t'i detyronte që të deklarohen në të shkruar nëse Kosova ka ndonjë lloj garancie apo jo për hyrje në BE.

f2) Në të njëjtën mënyrë Kosova ndërkohë duhet që të aplikojë edhe për anëtarësim në NATO, të kërkojë përgjigje legale me shkrim nga NATO për Pfp (Partneriteti për Paqe) për të cilën ka aplikuar në 2012, si lloj 'confidence building measure' me katër shtetet evropiane të NATO-s që nuk po e njohin pavarësinë.

Edhe nëse NATO do të gjente arsytetime legale negative njëjtë sikur BE-së, për Pfp dhe anëtarësim, testimi do të ishte i njëjtë edhe për vendet e NATO-s rreth premtimeve ndaj Kosovës për anëtarësim në NATO.

Gjendja ekonomike në Kosovë, investimet e jashtme, Trepça, vendet e punës në sektorin privat g) Gjatë tërë kësaj kohe Kosova duhet t'i nxisë kompanitë perëndimore për investime në Kosovë me çfarë do të fillonte rritja e prodhimit, eksportit dhe punësimet në sektorin privat.

Qeveritë e BE-së duhet të jenë ndihmëtare në këtë çështje madhore, po ashtu në kuadër të 'confidence measure building' Kosovë-BE, si lloj garancie e zhvillimit ekonomik në mënyrë që Kosova të ecë në rrugën e premtuar nga vetë BE-ja si ekonomi solide që synon hyrje në familjen evropiane e të të njëjtën kohë si lloj mënyrë konkrete për ta ndalur largimin e të rinjve nga vendi.

Kosova duhet të gjejë investitorë perëndimorë që të ringjallë dhe të fillojë ta nxjerrë maksimumin nga Trepça para se të pihen kushtet për njohjen nga Serbia e jo të merret me Trepçën pas marrëveshjes përfundimtare. Trepça duhet që të ringjallet bashkë me investitorët e jashtëm për ta rritur vlerën e xeheve përmes prodhimit gjysmëfinal dhe final, e jo vetëm nxjerrë xehe dhe shitur atë siç po bëhet tash me përfitime minimale. Këta hapa të lartshënuar do të fillonin që të bindin gradualisht vendet e BE-së dhe të NATO-s se Kosova dhe populli i saj nuk duron më që të trajtohen si rast humanitar, por si partner që e do hyrjen në BE dhe NATO dhe si vend që eksportin stabilitet për krejt rajonin në të mirë edhe të Evropës.

Serbia e Aleksandar Vuçiqit po e bën të kundërtën, ajo po e shantazon BE-në me destabilizim në Bosnjë, Mal të Zi dhe veri të Kosovës dhe kufijtë e saj.

Do të varet nga guximi i LV-së dhe krerëve të saj nëse qasja e Kosovës, qasja e popullit të Kosovës ndaj vetvetes e pastaj edhe ndaj Perëndimit do të ndryshojë, përkundër presioneve e joshjet nga më të ndryshmet që pritet që të rriten tash e tutje nga BE-ja dhe ShBA-ja ndaj Kosovës dhe shqiptarëve të saj për kompromis me Serbinë.

(Autori është themelues i agjencisë të lajmeve dtt-net.com dhe gazetar në Bruksel)



Piraj: Duhet të iniciohet reforma totale e politikave tatimore në vend



Prodhuesi vendor nga kompania "Meka", Burim Piraj, ka thënë se qeveria e re duhet të merret me iniciimin e reformave të politikave tatimore. Sipas tij, shteti duhet të marrë përgjegjësi kur të ketë kontest ekonomik në mes shtetit dhe biznesit, në mënyrë që mos të ndëshkohen bizneset përpara se të përfundojë procesi juridik

të drejtpërdrejta në mënyrë që të zbutet papunësia në vend", ka deklaruar prodhuesi vendor, Burim Piraj.

Sipas tij, ndër gjërat kryesore të qeverisë së re do të duhej që kur të ketë kontest ekonomik në mes shtetit dhe bizneseve, të mos ndëshkohen bizneset përpara se të përfundojë procesi juridik. "Një nga gjërat kryesore në këtë drejtim do të duhej që shteti të marrë përgjegjësi edhe kur të ketë kontest ekonomik në mes shtetit dhe bizneseve, pra të mos ndëshkohen bizneset përpara se të përfundojë procesi juridik. Për shembull, nëse një biznesi nga kontrolli i ATK-së i figurojnë gabime të paqëllimshme ose të

qëllimshme, të mos detyrohet të paguajë diferencë nga kontrolli sikur që është tani pa përfunduar procesi i ankimit deri në fund", ka thënë Piraj. Ai ka shtuar se shumë biznese janë dëmtuar pasi po detyrojnë të paguajnë shuma të mëdha parash dhe që në fund të dalin të pafajshëm pas pesë vjetësh e pastaj t'u kthehen mjetet. "Kjo gjë është shumë e keqe dhe për këtë shteti duhet ta reformojë këtë pikë", ka thënë Piraj. Ai ka thënë se qeveria e re duhet të dalë në terren për t'i parë sfidat e bizneseve. "Tani qeveria e re duhet të dalë në terren ashtu siç ka dalë në fushatë. Pra, t'i marrë seriozisht vërejtjet e bizneseve", ka thënë pronari i kompanisë "Meka", Burim Piraj.

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 SHKURT - Prodhuesi vendor nga kompania "Meka", Burim Piraj, ka thënë se Kosova është vonuar në reformat ekonomike. Sipas tij, çdo vonesë në këtë drejtim do të ketë ndikim në rrjedhat ekonomike të vendit. "Ne jemi shumë vonë me reformën ekonomike dhe përmirësimin

e klimës të të bërit biznes. Prandaj, vonimi disamujor nuk do të ketë ndikim në rrjedhat e ekonomisë, sepse si institucionet financiare ashtu edhe institucionet e shtetit për kontrollin dhe mbarëvajtjen e ekonomisë do të funksionojnë normalisht", ka thënë Piraj. Ai ka thënë se qeveria e re duhet të bëjë reforma totale të politikave tatimore, ndërkaq thotë se fokus të veçantë duhet t'i kushtojë tërheqjes së

investimeve të huaja. "Buxheti është miratuar nga Kuvendi para shpalljes së zgjedhjeve. Kështu që nuk pritet ndonjë ndikim në këtë aspekt. Qeveria e re ka shumë punë. Duhet të iniciohet reforma totale e politikave tatimore në vend dhe të përmirësohen shërbimet e institucioneve karshi bizneseve. Ajo që është shumë thelbësore, duhet të punohet në hapjen e Kosovës për investime ndërkombëtare

BQK-ja dhe policia vazhdojnë bashkëpunimin

PRISHTINË, 16 SHKURT (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, i shoqëruar edhe nga zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare, Sokol Havolli, ka pritur në takim drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti.

Në këtë takim është diskutuar për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm mes dy institucioneve me qëllim të luftimit dhe parandalimit të



dukurive negative. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka njoftuar drejtorin e përgjithshëm të

Policisë së Kosovës me zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe masat që janë ndërmarrë në

ruajtjen e stabiliteti financiar. Nga ana tjetër, drejtori i përgjithshëm i Policisë së

Kosovës, Samedin Mehmeti, ka falënderuar guvernatorin e BQK-së për bashkëpunimin e deritashëm, njëkohësisht shprehu gatishmërinë dhe përkrahjen për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë. Të dyja institucionet shprehën përkushtimin për shtimin e punës ndërinstitucionale me qëllim që të shkurtrohet numri i automjeteve të paregjistruara dhe të pasiguruara, si kriter për procedurat e mëtejme për çështjen e kartonit të gjelbër.

Shoqata 'Jetimat e Ballkanit' do të ndërtojë thertore në vlerë 2.5 milionë euro

SUHAREKË, 16 SHKURT (ER) - Shoqata "Jetimat e Ballkanit" do të ndërtojë një thertore me vlerë 2.5 milionë euro e cila do të jetë në shërbim të shoqatës dhe të qytetarëve. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj. "2.5 milionë euro është vlera e projektit të ri nga Shoqata 'Jetimat e Ballkanit', ku do të ndërtohet një thertore e cila do të mbetet në shërbim të kësaj shoqate dhe në

shërbim të qytetarëve", ka thënë Muharremaj. Ai ka njoftuar se me anë të kësaj kontrate do të krijohen 50 vende pune. "Sot u nënshkrua kontrata në mes të Komunës së Suharekës dhe Shoqatës 'Jetimat e Ballkanit', ku do të krijohen 50 vende të reja pune. Angazhimin dhe punën nuk e ndalim derisa të rregullohet jeta dhe mirëqenia e qytetarëve", ka thënë Muharremaj.



Komuna e Prizrenit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me ADA-n



PRIZREN, 16 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe udhëheqësja e Zyrës Koordinuese për Bashkëpunim Zhvillimor të Austrisë në Prishtinë (ADA), Sandra Horina, kanë nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi përmes së cilës do të bashkëfinancohet projekti SIREN (Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe

Gjithëpërfshirës Ekonomik Rural), që ka për qëllim rritjen e të ardhurave dhe produktivitetit të prodhuesve bujqësorë, duke promovuar sisteme të reja e të qëndrueshme për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në treg. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, për realizimin e këtij projekti që do të implementohet nga Caritasi zviceran, komuna do të ofrojë 15 000 euro,

ndërkaq Zyra Koordinuese për Bashkëpunim Zhvillimor të Austrisë (ADA) do të sigurojë fonde financiare në vlerë prej 100 000 eurosh. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka deklaruar se zhvillimi i bujqësisë është një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik, andaj puna e Komunës së Prizrenit në këtë drejtim do të rritet çdo ditë e më shumë.

61 pacientë me Covid në spitalin e Pejës

PEJË, 16 SHKURT (ER) - "61 pacientë janë duke u trajtuar aktualisht në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë me Covid-19" ka njoftuar Spitali i Pejës. Sa i përket gjendjes së pacientëve: pesë pacientë janë në respirator (CPAP), 46 pacientë janë në

oksigenoterapi, ndërsa prej këtyre 14 pacientë janë në gjendje më të rëndë. Gjatë 24 orëve të fundit në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë, 236 pacientë kanë marrë trajtim emergjent shëndetësor, kurse 27 prej këtyre janë shtrirë për trajtim të mëtutjeshëm.



UN-Habitati ofron përkrahje për Komunën e Mitrovicës

MITROVICË, 16 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri dhe nënkryetari Faruk Mujka kanë pritur të martën përfaqësuesin e ri të UN-Habitatit në Kosovë, Omar Siddique. Komuna e Mitrovicës dhe UN-Habitati kanë bashkëpunim të mirë për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZH), hartave zonale si dhe në projekte të tjera komunale. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka uruar Siddiquen për përgjegjësinë e tij në këtë program me rëndësi të Kombeve të Bashkuara, duke i ofruar bashkëpunim të plotë për realizimin e projekteve të përbashkëta. Ndërsa shefi i ri i UN-Habitat

për Kosovë, Omar Siddique, ka thënë se është i informuar me planin zhvillimor komunal, planin e mobilitetit i cili është model për komunat e tjera në nivel të Kosovës, si dhe për zhvillimet në fushën e ekonomisë dhe të investimeve kapitale në komunë e Mitrovicës. Gjatë këtij takimi është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit "Plotësimi i rrjetit të hapësirave publike përgjatë lumit Ibër dhe liqenit artificial" në vlerë prej 178 mijë dollarësh, projekt ky që ka për synim të krijojë shtigje të reja të çiklizmit rekreativ buzë lumit Ibër dhe përgjatë liqenit artificial, si dhe rigjenerimin e



një hapësire të gjelbër në "Mahallën e Romëve". Po ashtu, u diskutua që në


kuadër të ditëve globale të organizohet Dita e Biçikletës, si një formë e qëndrueshme e

mobilitetit dhe për ta promovuar udhëtimin me biçikletë.

NË VEND TË PARATHËNIES

Majat e maleve
Me parzmën time i kam mprehur
Mbi fosforin tim sofrën e kam shtruar
Gosti për perëndi
Me këngë rituale
Duke i pagëzuar brezat
Unë re mbi re
Largova myshkun e shekujve
Rrugëve kah eci
E ndjej trokun e kalit
Heroit të Motit të Madh
Hijen ia preku
Në Dardani u pagëzua kuq e zi
Duke bërë epoka
Me ngjyrën e dejve të mi
E ty
Nga ç'nëmë nëne të është gurëzuar zemra
Thith gjakun e dejve të mi
E perëndive sofrën ua trazon
Mijëra vjet ditëlindjen ARBËRI
Ta këndoj

(Elife LUZHA)



Hapet ekspozita e fotografisë 'Kujtesa e Kosovës rambouillet' e reporterit Asllan Krasniqi




Në kuadër të 13-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, të martën është hapur ekspozita e fotografisë "Kujtesa e Kosovës rambouillet" e reporterit Asllan Krasniqi, fotografi të cilat rrëfejnë momente nga konferenca e Rambujesë. Drejtori i Bibliotekës Kombëtare, Fazli Gajraku, tha

se fotografitë e Asllan Krasniqit paraqesin ngjarjet më të dhimbshme të historisë së Kosovës. Teksa shtoi se është nder që fotografitë e sotme po ekspozohen për të parën herë në Bibliotekën Kombëtare.

"Këto janë fotografi që nuk janë parë asnjëherë, dhe janë

fotografi që sjellin ngjarjen e Rambujesë, një dokumentim i historisë së Kosovës. Të gjitha ngjarjet e gëzueshme dhe të dhimbshme të Kosovës, autori Asllan Krasniqi i ka dokumentuar përmes fotografisë. Jemi të nderuar që kjo ekspozitë është hapur në bibliotekën Kombëtare të Kosovës", tha ai.






QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Erblin Bardhoshi, shqiptari që po shkëlqen në futbollin amerikan

Kosova e ka edhe një sportist që po shkëlqen në Gjermani. Bëhet fjalë për Erblin Bardhoshin i cili është mjaft i suksesshëm në futbollin amerikan. Ai këtë vit është transferuar nga Bielefeld Bulldogs te Paderborn Dolphins. "Këtë vit kam vendosur të luaj për Paderborn Dolphins, i cili është një ekip 30 minuta larg Bielefeldit. Kam vendosur ta ndërroj ekipin për shkak se Paderborni më ka bërë një ofertë më të mirë se Bielefeldi. Paderborni, po ashtu, luan në ligën e tretë të Gjermanisë dhe nëse na lejohet të luajmë sivjet, synim e kemi të ngrehemi në Ligën e Dytë të Gjermanisë", ka thënë ai



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 SHKURT - Erblin Bardhoshi ka filluar të merret me futbollin amerikan para katër vjetësh. Bardhoshi të martën në një bisedë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se në të kaluarën nuk ka menduar asnjëherë se do të luajë në këtë sport. Erblini tregon se futbollin amerikan është shumë i popullarizuar në Amerikë ashtu sikurse futbollin në Evropë. "Që katër vjet më parë kam luajtur në futbollin normal dhe nuk e kam pasur në mend këtë lojë dhe nuk e kam ditur se ekziston ky sport në Gjermani,

por tash është duke u rritur çdo vit e më shumë", ka thënë Erblin Bardhoshi.

Futbollin amerikan nuk dallohet me lojtarë të futbollit normal, pasi çdo ekip duhet t'i ketë nga 11 lojtarë në fushë dhe dallimi me futbollin normal është se lojtarët mund të ndërrohen sa herë që është e nevojshme, pra për këtë arsye i kanë 40 lojtarë rezervë. Erblin Bardhoshi më pas ka folur në detaje për zhvillimin e karrierës së tij në këtë sport mjaft atraktiv. "Në fillim ka qenë sport i komplikuar, por me ndihmën e një shoku kam kuptuar shpejt rregullat e lojës. Pas një viti kam filluar të merrem intensivisht dhe normalisht se ishte shumë

interesant si sport. Në vitin 2016, kur isha 21 vjeç, ia kam filluar te Bielefeldi, por fillimisht kam shkuar në prova për ta parë mundësinë se a jam lojtar adekuat për këtë sport.

Trajnerit të Bielefeldit i kam pëlqyer qysh kam ushtruar dhe më ka dhënë vullnet që të vazhdojë të merrem me këtë sport. Pra, ekipi im i parë ka qenë Bielefeld Bulldogs ku kemi luajtur për dy vjet në Ligën e Dytë të Gjermanisë. Pastaj kemi rënë në ligën e tretë, por në çdo vit e kemi zënë vendin e dytë në ligë", ka deklaruar ai.

Djaloshi shqiptar këtë vit është

transferuar në ekipin e Paderborn Dolphins, pasi ky klub i ka ofruar kushte më të mira se ish-klubi i tij, Bielefeld. "Këtë vit kam vendosur të luaj për Paderborn Dolphins, i cili është një ekip 30 minuta larg Bielefeldit. Kam vendosur ta ndërroj ekipin për shkak se Paderborni më ka bërë një ofertë më të mirë sesa Bielefeldi. Paderborni luan në Ligën e Tretë të Gjermanisë dhe nëse na lejohet të luajmë sivjet, synim kemi të ngrehemi në Ligën e Dytë të Gjermanisë", ka thënë Erblin Bardhoshi.

Sportisti me prejardhje nga Gjakova ka treguar edhe për

dallimin në mes të futbollit normal dhe futbollit amerikan. "Përpara e këqyrshim veç në televizion dhe kurrë nuk më ka shkuar mendja se do të luaj në këtë sport, pasi e kam pasur përshtypjen se është i komplikuar. Futbollin amerikan është i popullarizuar nëpër kolegje dhe fakultete të Amerikës. Dallimi me futbollin është se kjo lojë luhet me fuqi dhe me teknikë, sidomos me kokë. Duhet me qenë shumë i përgatitur. Fitnesi ka shumë rëndësi në këtë sport dhe nëse nuk je i përgatitur, është mirë të mos rrezikosh dhe të luash", ka përfunduar Bardhoshi.

Vëllazërorja e yjeve të futbollit shqiptar mbyllet pa fitues

PRISHTINË, 16 SHKURT - Emra të njohur të futbollit shqiptar nga të dyja anët e kufirit kanë zbritur të martën në fushën e stadiumit të "KF 2 Korriku" në Prishtinë. Në kuadër të shënimit të 13-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në organizim të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Ligës së Veteranëve të Futbollit të Kosovës është zhvilluar ndeshja ndërmjet veteranëve të futbollit të Kosovës dhe veteranëve të futbollit të Shqipërisë, e që u ndoq nga afër edhe nga presidenti i FFK-së, Agim Ademi, i cili para ndeshjes

shkëmbu nga një dhuratë me Sylejman Memën. "Është kënaqësi e madhe t'i shohësh yjet e futbollit shqiptarë sërish në fushën e gjelbër. Ne si federatë e organizuam këtë ndeshje në kuadër të shënimit të aktiviteteve shtetërore për Ditën e Pavarësisë. Besoj se në të ardhmen ndeshjet e tilla do të kemi mundësi t'i organizojmë me praninë e tifozëve, ngase këto yje të futbollit na kanë dhënë emocione të mëdha ndër vite dhe kanë bërë që shpesh t'i harrojmë edhe vështirësitë nëpër të cilat kemi kaluar si komb", ka thënë Agim



Ademi, kryetar i FFK-së. Në një rën anë ish-futbollistë të njohur të Kosovës si Muharrem Sahiti, Eroll Salihu, Shaban Baholli, Haxhi Zeka, Bedredin Gjinali dhe në anën tjetër yjet e

Kombëtares shqiptare ndër vite si Altin Lala, Alban Bushi, Erjon Bogdani, Armend Dallku e Klodian Duro shfaqën lojë atraktive përgjatë 80 minutave, duke dëshmuar se pavarësisht

moshës dhe peshës klasi nuk ndryshon. Edhe pse të dyja palët patën disa raste të mira shënimi në fund rrjetat e portave mbetën të paprekura. Kështu, kjo vëllazërore u mbyll baras, derisa tek të gjithë pjesëmarrësit u vërejt dëshira që ndeshje si kjo në të ardhmen të jenë tradicionale dhe të mbushen stadiumet me tifozë, qoftë në Prishtinë apo Tiranë. Kjo ndeshje ishte parashikuar të zhvillohej në stadiumin "Fadil Vokrri", por u zhvendos në fushën me bari artificial për shkak të reshjeve të mëdha të borës.

Boksierët e Kosovës në turneun ndërkombëtar 'Perla e Adriatikut'

Prishtinë, 16 shkurt - Federata e Boksit e Kosovës ka njoftuar se Përfaqësuesja e Kosovës U18 të martën ka mbërritur në Bar të Malit të Zi për turneun ndërkombëtar "Perla e

Adriatikut" që mbahet nga 16 deri më 22 të këtij muaji. Sipas njoftimit në fjalë, Kosova përfaqësohet me tre boksierë - Luar Aliu, Çlirim Berisha dhe Remzo Mustafiç, po ashtu

edhe nga selektori Shefki Bogujevci dhe gjyqtari ndërkombëtar Latif Demolli. "Në këtë turne marrin pjesë boksierët më të mirë të Evropës dhe kjo është një

sprovë para kampionatit botëror që do të mbahet në muajin prill në Kielce të Polonisë", thuhet në njoftimin e Federatës së Boksit të Kosovës.



Marku: Shqiptarë, mezi pres t'ju bëj krenarë

TI RANË, 16 SHKURT - Florian Marku po bëhet gati për duelin kundër Rylan Charlton, që do të zhvillohet më 20 shkurt në Londër. Boksieri shqiptar, pas shtatë fitoresh, u ndal në barazim në muajin dhjetor dhe

tani kërkon që të tregojë se mund të arrijë lart në këtë sport. Marku, mjaft i dashur për shqiptarët, në rrjetet sociale ka postuar një video dhe jep detaje për duelin e tij me Charlton dhe premtion që

do t'i bëjë të gjithë krenarë. "Përshëndetje të gjithëve! Ndeshja është të shtunën dhe do të transmetohet 'live' në Sky Sport dhe DAZN. Mezi po pres. Peshimi është të premtion. Kundërshtari është Rylan

Charlton. Jam përgatitur si kurrë më parë dhe mezi pres t'ju bëj krenarë. Ndeshja ime është e parafundit dhe pritet të jetë rreth orës 21:00, 21:30 me orën lokale në Angli", ka deklaruar Marku.



Hajrizi, lideri i Kosovës në parakualifikime

PRISHTINË, 16 SHKURT - Drilon Hajrizi është top-përformuesi i Kosovës në parakualifikimet evropiane për Kupën e Botës 2023. Kosova ka zhvilluar katër ndeshje, ku ka dy fitore dhe dy humbje, megjithatë është përballur me mungesa të shumta gjatë rrugëtimit. Hajrizi ka efektshmëri prej 23 për ndeshje, duke u pasuar nga Gëzim Morina me 13 dhe Erjon Kastrati me 12. Basketbollisti nga Mitrovica ka 16 pikë për ndeshje, duke u pasur nga Erjon Kastrati dhe Dardan Berisha me nga 13. Berisha nuk ka luajtur në ndeshjet e nëntorit për shkak të infektimit me Covid-19. Hajrizi prin edhe te kërcimet me 6.5 për ndeshje, Berisha ka



4, ashtu si edhe Alban Veseli. Ish-basketbollisti i Pejës, Bashkimit e Sigal Prishtinës ndodhet në vendin e parë, edhe sa iu përket asistimeve me 4.5, duke u ndjekur nga Dardan Berisha me 4 dhe Erjon Kastrati me 3.

Clippersat mposhtin edhe Miamin

LOS ANXHELOS, 16 SHKURT - Los Angeles Clippersi vijon momentin e mirë në kampionat, pasi ka marrë një tjetër fitore dhe tani është shumë pranë parakualifikimit të Lakersave në renditjen e Konferencës së Perëndimit. Skuadra e drejtuar nga Tyronn Lue ia doli të triumfojë me shifrat 125-118 ndaj Miami Heatit në "Staples Center" të Kalifornisë. Fraksioni i parë dhe i tretë shkuan në favor të Miamit, ndërsa vendësit fituan pjesën e dytë dhe të katërt, por me rezultat shumë më të thellë, duke ia dalë ta marrë suksesin e katërt radhazi dhe të 21-tin këtë sezon. Marcus Morris ishte protagonist i padiskutueshëm i Clippersave në suksesin e sotëm, pasi shënoi 32 pikë, rikuperoi tre topa dhe dha dy asistime, ndërsa për Miamin shkëlqeu Butler me 30 pikë, 10 asistime dhe 10 topa të rikuperuar. Vijon të bëjë mirë ndërkohë Utah Jazzi, që mori një tjetër sukses këtë herë me shifrat 134-123 në ndeshjen ndaj Philadelphia 76ers. Këta të fundit e nisën mjaft mirë ndeshjen dhe fituan fraksionin e parë me shifrat 35-42, por më



pas lëshuar terren dhe panë t'u përmysej rezultati. Basketbollisti australian i 76ers, Ben Simmons, ishte më i miri i ndeshjes me 42 pikë të shënuara, 10 asistime dhe 10 topa të rikuperuar, ndërsa për vendësit e Jazzit spikati Clarkson me 40 pikë të shënuara dhe një asistim, raporton "Supersport". Një tjetër sfidë interesante ishte edhe ajo në mes të Washington Wizardsit e Houston Rocketsit, me vendësit që triumfuan me shifrat 131-119 dhe regjistruan suksesin e dytë radhazi. Kjo ishte humbja e 6 radhazi për Houstonin që është zhytur në krizë rezultatesh këtë sezon dhe në 27 ndeshje numëron 16 humbje e vetëm 11 fitore, ndërsa

te Wizardsi është Beali që konfirmohet në formë mjaft të mirë dhe tërheq skuadrën me lojën e tij. Mori fitoren e tretë radhazi edhe Brooklyn Netsi, që ia doli të triumfojë me shifrat 125-136 në transfertën e "Golden 1 Arenës" ndaj Sacramento Kingsit. Irvingu ishte protagonist i Netsit me 40 pikë, 4 asistime e tri rikuperime, ndërsa një ndeshje mjaft të mirë bëri edhe James Hardeni me 29 pikë, 13 rikuperime e 14 asistime. Në sfidat e tjera, Chicago Bulls fitoi vetëm pas kohës shtesë ndaj Indiana Pacersit me shifrat 112-120, ndërsa New York Knicksi mposhti Atlanta Hawksin me shifrat 123-112.

SHKURT

Mustafi, lojtari më i vlerësuar i javës në Bundesligë

Me ndeshjen në mes të Bayern Munichut dhe Arminia Bielefeldit u mbyll java e 21-të në Bundesligë. Pas çdo jave "WhoScored" bën publikimin e formacionit të javës në top pesë ligat evropiane. Në Bundesligë, Shkodran Mustafi ka hyrë në formacionin e javës dhe është vlerësuar me notën më të lartë nga të gjithë të tjerët. Schalke barazoi pa gola ndaj Union Berlinit, por ish-qendërmbrojtësi i Arsenalit tregoi kualitetin e tij.

Oferta me bollëk, por kjo është kërkesa e Alabas

David Alaba është kthyer në emrin më të lakuar në merkaton e transferimeve, për vetë faktin se në fund të sezonit do të largohet me parametra zero, ndërsa për shërbimet e tij mbeten në gara disa nga klubet më të rëndësishme në Evropë. Fakt është që Alaba po largohet nga Bayerni vetëm për një pagë më të mirë, ndërsa agjentit e tij po bëjnë gjithçka është e mundur për t'i siguruar një kontratë faraonike. Sipas mediave në ishull, Alaba kërkon një kontratë pesëvjeçare dhe 22 milionë euro neto në sezon. Real Madridi, Barcelona, Chelsea dhe Manchester City janë klubet që prej kohësh po ndjekin nga afër situatën e Alabas.

E ardhmja e Van de Beek, mes Ajaxit, Milanit dhe Barçës

Mesfushori Donny Van de Beek nuk po përshtatet në skuadrën e Manchester Unitedit dhe largimi në afatin kalimtar të verës duket i pashmangshëm. Mediat në ishull njoftojnë se mesfushori 23-vjeçar mund të huazohet tek Ajaxi në mënyrë që ta rikthejë vetëbesimin e më pas të kthehet "Old Trafford". Unitedi kishte paguar 40 milionë euro për transferimin e tij. Interesim për mesfushorin holandez kanë shfaqur edhe Barcelona dhe Milani.

Zidane, objektiv i Juventusit

"Juventusi ka kontaktuar me Zidanen". Kjo është "bomba" indirekte që vjen nga Spanja, e hedhur gjatë programit "El Chiringuito". Sipas kolumnistit Eduardo Inda, shumë pranë qarqeve të Realit, e ardhmja e "Zizou" është larg Madridit. Prandaj, kontaktet me drejtuesit e Juventusit janë shpeshtuar. Sezioni i "Merengues" ka qenë i luhatur deri më tani. Pavarësisht nga tri fitoret radhazi në La Liga, Reali është i dyti në renditje, 5 pikë pas Atletico Madrid. Zidane, pavarësisht prej kontratës me klubin spanjoll, që skadon më 2022, është në diskutim dhe mund të largohet nga të bardhët në fund të këtij sezoni. E ardhmja e "Zizou" varet gjithashtu nga ecuria në Ligën e Kampionëve, ku Reali do të sfidojë si fillim Atalantën më 24 shkurt. Në të ardhmen Zidane, sipas "El Chiringuito", mund t'i ketë dy mundësi: Juventusin ose ekipin kombëtar francez, pasi federata franceze ka shprehur vazhdimisht dëshirën për ta pasur zëvendës të Didier Deschamps.

Flick: Barazimi ndaj Bielefeldit, me shije të fitores

Arminia Bielefeld vuri jo pak në vëshitësi Bayern Munchenin të hënën në "Allianz Arena", teksa kaloi edhe në avantazh të dyfishtë, por në fund e detyroi të largohej me vetëm një pikë të fituar, pasi

ndeshja përfundoi barazim 3-3. Tekniku i kampionëve të Gjermanisë, Hansi Flick, vlerësoi kundërshtarin për lojën e bërë dhe theksoi se skuadra e tij ishte e lodhur nga udhëtimet e gjata dhe

kalendari i ngjeshur, gjë që u reflektua edhe në fushën e lojës. "Arminia Bielefeld tregoi se mund të luajë futboll dhe kjo më pëlqeu shumë. U detyruam të bëjmë disa ndryshime në formacion për

shkak të mungesave, por ndikoi jo pak edhe lodhja, pasi kohët e fundit jemi përballur me kalendar të ngjeshur dhe udhëtime të gjata. Gjithsesi më pëlqeu jashtë mase besimi i skuadrës se mund t'ia

dilte edhe kur ishte në disavantazh të dy golave. Reaguar mjaft mirë në pjesën e dytë dhe mund të them se kjo na jep shijen e fitores, edhe pse morëm vetëm një pikë", ka thënë Flick.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Komuna Drenas/Gllogoc
KRYETARI I KOMUNËS



Nr.01- 464/01-6367 dt.10.02.2021

Në bazë të dispozitave të dispozitave të neneve 11, 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nenit 4, nenit 7 dhe nenit 8, paragrafi 5 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Vendimit të Kuvendit Komunal Drenas 12 nr.462/01-47383, dt.30.10.2020, për shpalljen interes i përgjithshëm publik, Vendimit të Kuvendit Komunal Drenas 12 nr.464/01-51562 dt.26.11.2020, për Shpronësimin e njësisve të ndërtesave - Banesave, për inicimin e procedurës së shpronësimit, Kryetari i Komunës së Drenasit merret:

VENDIM

I

Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga projekti "Plani Rregullues Urban Qendra 1" në Drenas, si dhe Plani Zhvillimor Komunal, sipas tabelave të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, si dhe sipërfaqet e tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.

II

Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205, dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

III

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IV

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njëren nga gazetat me tirazh më të madh.

Iu dërgohet:
-Drejtoria përkatëse
-Arkivit të Komunës dhe
-Pronarëve apo zotëruesve të interesit

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci
Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Komuna Drenas/Gllogoc
Kryetari i Komunës



Nr. 01- 070/03-6392 dt.10.02.2021

NJOFTIM

Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.01-464/01-6367, dt. 10.02.2021 njoftohen të gjithë subjektet e interesit se:

1. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik realizimi i projektit "Plani Rregullues Urban 1", pPlani Zhvillimor Komunal 2020-2028, mbas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Kryetari i Komunës në zbatim të ligjit të lartpërmendur, ka marrë Vendimin nr. 01-464/01-6367, dt.10.02.2021 për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës për shpronësim.
2. Kryetari i Komunës do të marrë një Vendim Preliminar brenda periudhës prej 30 ditëve kalendarike pas përbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, lidhur me organizimin e dëgjimeve publike.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin Shpronësues, brenda 10 ditëve kalendarike, mbas shpalljes së Vendimit të Kryetarit të Komunës 01-464/01-6367, dt.10.02.2021, për miratimin e kërkesës për shpronësim ditën e publikimit në njëren nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.
4. Kryetari i Komunës do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar për realizimin e projektit "Plani Rregullues Urban 1", Plani Zhvillimor Komunal 2020-2028 ku gjenden këto njësi kadastrale e që do t'i nënshtrohen procesit të shpronësimit.
5. Të gjithë personat që janë zyrtar publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronar ose zotërues të interesit në pronën e cila gjindet në këtë pjesë ose avokat apo përfaqësues i ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.
6. Çdo person i interesuar do t'i jepet mundësi e arsyeshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2, 3, 4 të nenit 9 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205.
7. Çdo person i interesuar i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjellë me vete prova të arsyeshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotëruesi i interesit.
8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave tjera në pronat e paluajtshme që ndodhen brenda juridiksionit territorial të komunës së Drenasit, do të mbahet me datë 16.03.2021 në ora 10:00, në objektin e Komunës së Drenasit – salla e Kuvendit.
9. Në rast se prona është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të inicuar në përputhje me atë kërkesë asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmirësimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përbushjes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose ndonjë interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtoj Ligjin Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e të drejtave të tyre sipas ligjit.
10. Çdo person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronat e paluajtshme që janë objekt shpronësimi duhet të dërgoj në organin shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikuara të çfarëdo dokumenti që ndërlidhen në atë pretendim.



KRYETARI I KOMUNËS
Ramiz Lladrovci
Ramiz Lladrovci

REGJISTRI I PRONAVE-BANESAVE TË CILAT DO TË PËRFSHIHEN NË PROCESIN E SHPRONËSIMIT

Z.K.K DRENAS						Z.K.DRENAS						
Gjendja e vjetër						Gjendja e re						
Nr.	Pronari	Identifikuesi kadastral	Shprehja	Lloji i ndërtimit	Lloji i ndërtimit	Nr.	Pronari	Identifikuesi kadastral	Shprehja	Lloji i ndërtimit	Lloji i ndërtimit	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	Isatogu Elver (Shaqiri)	0-70315016-00743-1-22-2-1-0	banesë	30		1	Komuna Drenas	0-70315016-00743-1-22-2-1-0	banesë	30	30	
2	Prokajti Nazir (Shaqiri)	0-70315016-00743-1-22-3-1-0	banesë	35		2	Komuna Drenas	0-70315016-00743-1-22-3-1-0	banesë	35	35	
3	Laku Tahir (Ukë)	0-70315016-00743-1-25-1-1-0	banesë	33		3	Komuna Drenas	0-70315016-00743-1-25-1-1-0	banesë	33	33	
4	Mazhuni Liridon (Halli) 1/2 Mazhuni Armend (Halli) 1/2	0-70315016-00743-1-25-2-1-0	banesë	33		4	Komuna Drenas	0-70315016-00743-1-25-2-1-0	banesë	33	33	
5	Hallit Xhater (Musli)	0-70315016-00743-1-25-3-1-0	banesë	33		5	Komuna Drenas	0-70315016-00743-1-25-3-1-0	banesë	33	33	
6	Hisonaj Agim (Ujkan)	0-70315016-00743-1-27-1-1-0	banesë	33		6	Komuna Drenas	0-70315016-00743-1-27-1-1-0	banesë	33	33	
7	Velliu Adnora (Murat)	0-70315016-00743-1-27-2-1-0	banesë	32.8		7	Komuna Drenas	0-70315016-00743-1-27-2-1-0	banesë	32.8	32.8	
				Gjithsejsh:	229.8					Gjithsejsh:	229.80	229.80



KOMPANIA REJONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

Tel: +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212), nenit 4 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.7/2017, Vendimit Nr. 11 të datës 15.02.2021 dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 17.01.2021 vendosi që të ri shpallë :

Konkurs publik

Për këtë pozitë

I. 1 /një/ **SHOFER me "C1E" kategori, me** kohë të caktuar (me kohëzgjatje 3/tre/vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Kushtet:

Të posedojnë nivelin e edukimit të mesëm, Patentë shoferi me "C1E" kategori, të ketë më së paku 1 (një) vite përvojë të punës relevante, dhe të mos jetë i dënuar ose nën hetime .

Kushtet e veçanta:

Të ketë aftësi të mira psikofizike të punës, puna kryhet me ngarkesa shtesë të detyrave të punës dhe në vende të ndryshme varësisht nga nevoja e punëdhënësit dhe mundësi të ndërrimit të vendit të punës për pozitë ekuivalente. Varësisht nga performanca e tij do t'i vazhdohet apo do t'i ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma , Referenca-Përvojë 1 (një) vit në punët relevante, Patentë Shoferi me "C1E" kategori dhe Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i dënuar (më e re se 6 gjashtë muaj).

Përshkrimi i detyrave të punës dhe përgjegjësitë:


- Sipas Urdhëresës së Punës drejton automjetin me rimorkio dhe kujdeset për rregullsinë, higjienën dhe pastërtinë e tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona) tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit-koordinatorit të autoparkut;
- Para daljes në teren merr Urdhëresën e Punës në të cilën evidencen punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet dhe të njëjtën e kthen te koordinatori i autoparkut;
- Vendos (monton) letrën e re të Tahogرافit ndërsa letrën paraprake e kthen te udhëheqësi, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letrën e Tahogرافit ka obligim që në të të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhin fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshesat etj.), për ekipin e punëtorëve me të cilët punon,
- Largon (bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhëresën e punës;
- Në rast nevojë ndërton gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmëron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Çdo sjellje të pandërgjegjshëm apo mungesë nga procesi i punës, të punëtorëve me të cilët punon, vozitësi është i obliguar ta paraqet te udhëheqësi i drejtpërdrejt brenda orarit të punës.
- E njofton udhëheqësin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër;
- Pas përfundimit të orarit të punës bënë pastrimin (larjen) e automjetit të punës dhe e parkon në vendin e caktuar; dhe
- Kryen punë tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes;

Paga: Përcaktohet nga Punëdhënësi në lartësinë e nivelit të vendit të punës.

Afati i paraqitjes së kërkesave është 7 ditë nga dita e publikimit, (nga data 17.02.2021 e deri me datë 24.02.2021 ora 16:00).

Kërkesën me dokumentacionin e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek menaxheri i Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë.

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së të testit (ngasjes) dhe intervistës.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Agron Demiri shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Shote Galica"

► D.P.Sh " Denisi shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 70832704

► Ferid Salih shpalle te pavlefshme dëftesën e lëshuar nga Diakonie Training Center me nr : 154/15,219/16,008/15,065/16,030/15

► Hajredin Destani shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLM "Dr Xheladin Deda".

► Doruntina Zogiani shpall të humbur diplomën e Fakultetit të FSHMN-së drejtimi Fizikë -arsimore, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", data e lëshimit diplomës 12 shkurt 2007.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

